



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.23.09.2021**

kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 37, zoti Alit Novrus Xhezar, i cili ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, ku nga verifikimi i këtij formulari, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë, e cila ka të bëjë me ndalimet e ligjit nr.138, të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës sonë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin, zotin Alit Novrus Xhezar, i cili rezulton se nuk ka shënime në sistem dhe është i padënuar. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer përgjigje ende kërkesës sonë. Referuar pikës 2 të kreut 5, të vendimit nr.17, të vitit 2016, të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar, zotit Alit Novrus Xhezar. në Këshillin e Bashkisë Korçë. nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës. Faleminderit!

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit! Atëherë bazuar në nenin 19 vijues të Kodit Zgjedhor si dhe ligjit nr.138/2015 vendos:

Zoti Alit Novrus Xhezar kandidat për anëtar, në Këshillin e Bashkisë Korçë nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.

Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Korçë me kandidatin nga lista shumëemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, zotin Alit Novrus Xhezar.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi dhe ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Vendim nr.453**

**Zbardhi materialin audio  
Merita Dulaku**



**23.09.2021  
Ora 13:09**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë, me kandidatin nga lista shumëemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zoti Rodolf Llambi Xhillari”.**

**PJESËMARRJA :**

• **KQZ**

- 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      Z.Illirjan Celibashi**  
**2.Stafi KQZ:    Y.Merkaj, M.Koja, B.Kodra**
- **Parti Politike:**

**Z.I.Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

**Z.Y.Merkaj:** Këshilli i Bashkisë Tiranë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në këshill, nga këshilltari Etien Xhafaj, propozuar nga Partia Socialiste. Kandidati vijues nga lista shumëemërore e Partisë Socialiste për Këshillin e Bashkisë Tiranë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 64, zoti Rodolf Llambi Xhillari, i cili ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit me numër unik:2180. Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit, konstatohet se kanë ndryshuar gjeneralitetet, nga Roland në Rodolf dhe mbiemrin nga Qirici në Xhillari. Gjithashtu në rubrikën 3, të dhënat mbi gjendjen gjyqësore të personit, ka deklaruar se është akuzuar për veprën penale kontrabandë në një doganë greke, në

**Zbardhi materialin audio  
Merita Dulaku**

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.23.09.2021*

vitin 1996. Përsa i përket veprave penale të kryera jashtë territorit të Shqipërisë, duke qenë se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka juridiksion dhe kompetencën për t'i ndjekur, i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme për verifikimin e plotë dhe deklarimeve të bëra nga kandidati për anëtar të këshillit të bashkisë, gjithashtu Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende s'ka kthyer përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore të kandidatit, zotit Rodolf Xhillari në Këshillin e Bashkisë Tiranë, ku rezulton i padënuar. Referuar pikës 2, të kreut të 5, të vendimit nr.17 të vitit 2016 të Kuvendit të Shqipërisë konstatohet se, të dhënat e kandidatit për anëtar të Këshillit të Bashkisë Tiranë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tij, në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës. Faleminderit!

**Z.I.Celibashi:** Mirë, atëherë bazuar në nenin 19 vijues të Kodit Zgjedhor, si dhe ligjit nr. 138/2015 vendos:

Zoti Rodolf Llambi Xhillari, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë, nga kandidati nga lista shumëemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zoti Rodolf Llambi Xhillari.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi dhe ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Vendim nr.454**

*Zbardhi materialin audio  
Merita Dulaku*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.23.09.2021*

vetëdeklarimit me numër unik 961. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve fillimisht ka bërë verifikimet paraprake për të dhënat e deklaruara nga këto subjekte dhe ka marrë informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Duke patur parasysh shënimet e bëra në formularin e vetëdeklarimit në rubrikën 3, të dhënat mbi gjendjen gjyqësore të personit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se në vitin 1997 është proceduar nga policia italiane në qytetin e Romës në Itali. Subjekti ka deklaruar se arsyen nuk e di të saktë për mungesë dokumentacioni, si dhe nuk ka dijeni se çfarë është vendosur për këtë çështje. Gjithashtu, pyetjes 8 “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë më shumë se një muaj?”, i është përgjigjur me përgjigjen “Po” dhe ka deklaruar se në vitin 1992-1993 ka jetuar në Itali për arsye emigracioni, dhe në mars të vitit 1997 deri në korrik të vitit 1997 ka jetuar në Itali. Referuar nenit 8 pika 1 të ligjit numër nr.138, të vitit 2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur t’ia kalojë rastin për verifikim më të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucion kompetent për kryerjen e verifikimeve të plota, për deklaratimet e bëra nga subjekti vetëdeklarues. Në datën 10.09.2021 Drejtoria e Koordinimit Institucional, sektori i dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendimin për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin Arsen Tare Belaj. Pas paraqitjes së rezultatit të verifikimit nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në zbatim të përcaktimit të nenit 10, të ligjit nr. 138, të vitit 2015, është organi kompetent, i cili nëpërmjet vendimmarrjes konstaton nëse ekzistojnë kushtet e ndalimit për kandidatin, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Zoti Arsen Tare Belaj, si kandidati i listës shumëemërore të Partisë Bindja Demokratike, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021, Qarku Vlorë, nuk ka marrë mandatin e deputetit. Subjekti zgjedhor Partia Bindja

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.23.09.2021**

Demokratike, referuar neneve 162 dhe 163 të Kodit Zgjedhor nuk ka fituar asnjë mandat dhe nuk rezulton të jetë anëtare e ndonjë koalicioni zgjedhor që ka fituar mandat, që do të kualifikonte listën shumëemërore të këtij subjekti për të fituar mandat në të ardhmen. Në këto kushte kur subjekti zgjedhor, kandidati i listës shumëemërore i Partisë Bindja Demokratike nuk mund të përfitonte mandat në këtë legjislaturë, Komisioneri nuk mund të shprehet për sa kohë që ky subjekt nuk gëzon statusin e deputetit. Komisioneri mund të shprehet vetëm kur të përmbushen kushtet ligjore, të moskandidimit apo moszgjedhshmërisë apo mbarimit të mandatit nga rastet e parashikuara në ligjin nr. 138, të vitit 2015. Në rastin e këtij shqyrtimi, në analizën dhe zbatimin të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 138 të vitit 2015, vlerësohet që ka humbur objektin dhe qëllimin e verifikimit të thelluar. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit.

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit! Mirë atëherë bazuar në nenin 19 pika 1, shkronja “n” dhe 2 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, neni 90 dhe 98 të Kodit të Procedurave Administrative si dhe ligjit nr. 138, të vitit 2015, vendos të deklaroj të përfunduar procedurën administrative pa vendim përfundimtar për subjektin vetëdeklarues, zotin Arsen Belaj. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së. Pikë tjetër nuk kemi në rendin e ditës. Mirë, faleminderit, seanca mbyllet.

**Vendimi nr.455**

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**

P 